



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE	
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr./Proj. / Org. Unit	Nr./Proj. / Prod. No.
01-H	8217/24
Nr./Faqe / Uz. Stranica	Nr./Faqe / Uz. Stranica
1	13.12.24
PRISHTINË / A	
No.1	

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) Nr. 18 2024 PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E
PLOTËSIMIT TË APLIKACIONIT PËR LEJE MJEDISORE TË INTEGRUAR

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MESPI) No. 18 2024 ON THE FORM, CONTENT AND METHOD OF
COMPLETING THE APPLICATION FOR INTEGRATED ENVIRONMENTAL PERMIT

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MŽSPPI) Br. 18 2024 O OBRASCI, SADRŽAJ I NAČIN POPUNJAVANJA
ZAHTEVA ZA INTEGRISANU EKOLOŠKU DOZVOLU

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndoftës, nenin 11(1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), si dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 17/2024 së Punës së Qeverisë, Nxjerrë: UDHËZIM ADMINISTRATIVM (MMPHI) Nr. ____ 2024 PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË APLIKACIONIT PËR LEJE MJEDISORE TË INTEGRUAR Neni 1 Qëllimi Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe mënyrën e plotësimit të aplikacionit për Leje Mjedisore të Integruar.	Minister of Environment, Spatial Planning and Infrastructure, Pursuant to Article 6 paragraph 4 of Law No. 08/L-145 on Integrated Pollution Prevention and Control, Article 11(1.5) of Law No. 08/L-117 for the Government of the Republic of Kosovo (Official Gazette, No. 34/22 dt. 18.11.2022), as well as Article 9 paragraph 2 of Regulation No. 17/2024 on Rules of Procedure of the Government, Issues: ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MESPI) No. ____ 2024 ON THE FORM, CONTENT AND METHOD OF COMPLETING THE APPLICATION FOR INTEGRATED ENVIRONMENTAL PERMIT Article 1 Purpose This Administrative Instruction aims to define the form, content and method of completing the application for Integrated Environmental Permit.	Ministar životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture, Na članu 6 stav 4 Zakona br. 08/L-145 o integrisanom sprečavanju i kontroli zagađenja, član 11(1.5) Zakona br. 08/L-117 za Vladu Republike Kosovo (Službeni list, br. 34/22 od 18.11.2022), kao i član 9 stav 2 Uredbe br. 17/2024 o radu Vlade, Donosi: ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MŽSPPI) Br. ____ 2024 O OBRASCU, SADRŽAJ I NAČIN POPUNJAVANJA ZAHTEVA ZA INTEGRISANU EKOLOŠKU DOZVOLU Član 1 Svrha Ovo Administrativno Uputstvo ima za cilj da definiše oblik, sadržaj i način popunjavanja zahteva za Integrisanu ekološku dozvolu.
--	--	---

Neni 2 Fushëveprimi 1. Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen për të gjitha institucionet, personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në procedurën e aplikimit, lëshimit dhe zbatimin e Lejes Mjedisore të Integruar. 2. Ky Udhëzim Administrativ është në përputhshmëri me Direktivën 2010/75/BE për emisionet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes).	Article 2 Scope 1. The provisions of this Administrative Instruction shall apply to all institutions, natural and legal persons that participate in the procedure of application, issuance and implementation of the Integrated Environmental Permit. 2. This Administrative Instruction is in compliance with European Commission Directive 2010/75/EU, on industrial emissions (integrated pollution prevention and control).	Član 2 Oblast delovanja 1. Odredbe ovog Administrativnog Uputstva primenjuju se na sve institucije, fizička i pravna lica koja učestvuju u postupku podnošenja zahteva, izdavanja i sprovođenja Integrisane ekološke dozvole. 2. Ovo Administrativno Uputstvo je u skladu sa Direktivom 2010/75/EU o industrijskim emisijama (sprečavanje i integrisana kontrola zagađenja).
Neni 3 Përkufizimet 1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime: 1.1. Leje - Leje Mjedisore e Integruar; 1.2. Operator - çdo person fizik ose juridik që operon ose kontrollon në tërësi një pjesë të impiantit, impiantet	Article 3 Definitions 1. The terms used in this Administrative Instruction have the following meanings: 1.1. Permit - Integrated Environmental Permit; 1.2. Operator - any natural or legal person that operates or wholly controls a part of the plant, combustion plants,	Član 3 Definicije 1. Izrazi koji se koriste u ovom Administrativnom Uputstvu imaju sledeća značenja: 1.1. Dozvola - Integrisana ekološka dozvola; 1.2. Operator - svako fizičko ili pravno lice koje upravlja ili u potpunosti kontroliše deo postrojenja, postrojenja

me djegie, impiantet për djegjen e mbeturinave ose impiantet e bashkë-djegjes së mbeturinave;	waste incineration plants or waste co-incineration plants;	za sagorevanje, postrojenja za spaljivanje otpada ili postrojenja za suspaljivanje otpada;
1.3. Komisioni - Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje;	1.3. Commission - Commission for Review of Applications for Permit;	1.3. Komisija - Komisija za razmatranje zahteva za izdavanje dozvola;
1.4. KPMM - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;	1.4. ICM - The Independent Commission for Mines and Minerals;	1.4. NKRM - Nezavisna komisija za rudnike i minerale;
1.5. Ministria - Ministria përgjegjëse për mjedis;	1.5. Ministry - Ministry responsible for the environment;	1.5. Ministarstvo - Odgovorno ministarstvo za životnu sredinu.
2. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç janë përcaktuar në Ligjin Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.	2. The terms and expressions used in this Administrative Instruction shall have the same meaning as defined in the Law No. 08/L-145 on Integrated Pollution Prevention and Control.	2. Izrazi i pojmovi koji se koriste u ovom Administrativnom uputstvu imaju isto značenje kao što je definisano Zakonom br. 08/L-145 za sprečavanje i integrisanu kontrolu zagađenja.
Neni 4 Obligimet e operatorit		
1. Operatori është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të paraqitura në aplikacionin për Leje.	1. The operator is responsible for the accuracy of the data presented in the Application for Permit.	1. Operator je odgovoran za tačnost podataka navedenih u zahtevu za izdavanje dozvole.
2. Për sistemin menaxhues mjedisor operatori është i obliguar të ketë personin përgjegjës për mjedis.	2. For the environmental management system, the operator is obliged to have the person responsible for the environment.	2. Za sistem upravljanja životnom sredinom operator je dužan da ima lice odgovorno za životnu sredinu.
Član 4 Obaveze operatora		

Neni 5 Veprimtaritë që janë subjekt i Lejes	Article 5 Activities that are subject to the Permit	Član 5 Delatnosti koje su predmet Dozvole
Të gjitha veprimtaritë të cilat janë të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes dhe kane Pëllqim Mjedisor janë të obliguara të pajisen me Leje.	All activities which are defined in Annex 1 of the Law No. 08/L-145 on Integrated Pollution Prevention and Control and have Environmental Consent are obliged to be equipped with a Permit.	Sve aktivnosti koje su definisane u Dodatku 1 Zakona br. 08/L-145 za sprečavanje i integrisanu kontrolu zagađivanja i imaju saglasnost za životnu sredinu dužni su da dobiju dozvolu.
Neni 6 Aplikacioni për Leje	Article 6 Application for Permit	Član 6 Zahtev za dozvolu
- Aplikacioni për Leje përmban: - Të dhënat e përgjithshme; - Përmbledhjen e të dhënave mbi veprimtarit dhe lejet e lëshuara; - Të dhënat për impiantin; - Shfrytëzimin e lendeve të para dhe ndihmëse; - Emissionet në ajër; - Emissionet në ujë; - Mbrojtja e tokës dhe të ujërave nëntokësore;	- Application for Permit shall contain: - General data; - Summary of the data on activities and issued permits; - Data about the plant; - The use of raw and auxiliary materials; - Air emissions; - Emissions to water; - Soil and groundwater protection;	- Zahtev za izdavanje dozvole sadrži: - Osnovni podaci; - Rezime podataka o aktivnostima i izdatim dozvolama; - Podaci o postrojenju; - Upotreba sirovina i pomoćnih materijala; - Emisije u vazduh; - Emisije u vodi; - Zaštita zemljišta i podzemnih voda;

1.8. Menaxhimi me mbeturina; 1.9. Zhurma dhe vibrimi; 1.10. Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësia e theksuara; 1.11. Masat në rastet e punës jo stabile të impiantit; 1.12. Ndërprerjen e pjesshme ose të plotë të punës së impiantit. Neni 7 Kushtet për Leje 1. Për te u pajisur me Leje çdo operator duhet të paraqesë në Ministri apo në mënyrë elektronike: 1.1. Aplikacionin për Leje në kopje fizike dhe një (1) kopje elektronike në CD; 1.2. Kopje Certifikatën e biznesit; 1.3. Kopje Vendimin e Pëlqimit Mjedisor; 1.4. Kopje Certifikatën e përdorimit	1.8. Waste management; 1.9. Noise and vibration; 1.10. Assessment the risk from the noted disasters; 1.11. Measures in cases of unstable work of the plant; 1.12. Partial or complete interruption of plant work. Article 7 Permit Conditions 1. In order to be provided with a Permit, each operator must submit to the Ministry or electronically: 1.1. Application for Permit in physical copy and one (1) electronic copy on CD; 1.2. Copy Business certificate; 1.3. Copy Decision on Environmental Consent; 1.4. Copy The certificate of use or the	1.8. Upravljanje otpadom; 1.9. Buka i vibracije; 1.10. Procena rizika od naglašene katastrofe; 1.11. Mere u slučajevima nestabilnog rada postrojenja; 1.12. Delimični ili potpuni prekid rada postrojenja. Član 7 Uслови дозволе 1. Da bi dobio Dozvolu, svaki operater mora dostaviti Ministarstvu, ili elektronski: 1.1. Zahtev za izdavanje dozvole u fizičkoj kopiji i jednoj (1) elektronskoj kopiji na CD-u; 1.2. Kopija Poslovni sertifikat; 1.3. Kopija Odluka o saglasnosti za životnu sredinu; 1.4. Kopija Potvrda o upotrebi ili
---	--	--

apo dokumentin nga Komuna apo Ministria për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me kërkesën për leje dhe pëlqim mjedisor;	document from the Municipality or the Ministry for the permission to exercise the activity in accordance with the application for permit and environmental consent;	dokument opštine ili Ministarstva za dozvolu za obavljanje delatnosti u skladu sa zahtevom za dozvolu i ekološku saglasnost;
1.5. Kopje Lejen ujore për shfrytëzim të ujit;	1.5. Copy Water permit for water use;	1.5. Kopija Vodna dozvola za korišćenje vode;
1.6. Kopje Lejen ujore për shkarkim të ujit ;	1.6. Copy Water permit for water discharge;	1.6. Kopija Vodna dozvola za ispuštanje vode;
1.7. Kopje Lejen për aktivitete të veçanta nga KPM;M;	1.7. Copy Permission for special activities from ICMM;	1.7. Kopija Dozvola za posebne aktivnosti od NKR;M;
1.8. Kopje Licencën për shfrytëzim të resurseve natyrore nga KPM;M;	1.8. Copy License for exploitation of natural resources from ICMM;	1.8. Kopija Licenca za eksploataciju prirodnih resursa od NKR;M;
1.9. Kopje Pëlqimin nga autoriteti përgjegjës për emergjencë;	1.9. Copy Consent from the authority responsible for emergencies;	1.9. Kopija Saglasnost organa nadležnog za vanredne situacije;
1.10. Kopje Certifikatën për enët nën shtypje;	1.10. Copy The certificate for pressure vessels;	1.10. Kopija Sertifikat za sretstva pod pritiskom;
1.11. Kopje Certifikatën për standardin ISO 14001 (Standardi Ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor);	1.11. Copy Certificate for the ISO 14001 standard (International Standard for Environmental Management System);	1.11. Kopija Sertifikat za standard ISO 14001 (Međunarodni standard za sistem upravljanja životnom sredinom);
1.12. Fletëpagesën e tarifës për leje.	1.12. The payment slip on permit fee.	1.12. Uplatnica za izdavanje dozvole.

2. Aplikacionit për leje mund t'i bashkëngjitet edhe ndonjë informata shtesë të cilën komisioni apo aplikuesi e konsideron të nevojshme. 3. Deri në zhvillimin e sistemit elektronik, aplikuesit paraqesin aplikacionin në formë fizike në Ministri. Pas zhvillimit të këtij sistemi, procedura do të zhvillohet në formë elektronike nëpërmjet ndërveprimit të regjistrave publik.	2. Any additional information that the Commission or the applicant considers necessary may be attached to the permit application. 3. Until the development of the electronic system, applicants submit the application in physical form to the Ministry. After the development of this system, the procedure will be developed electronically through the interaction of public registers.	2. Uz zahtev za dobijanje dozvole mogu se priložiti sve dodatne informacije koje komisija ili podnosilac smatra neophodnim. 3. Do razvoja elektronskog sistema, podnosioci prijave u fizičkom obliku podnose Ministarstvu. Nakon razvoja ovog sistema, postupak će se razvijati elektronski kroz interakciju javnih registara
Neni 8 Shtojcat 1. Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrative janë: 1.1. Shtojca 1 - Aplikacioni për dhënien e lejes mjedisore të integruar; 1.2. Shtojca 2 - Mënyra e plotësimit të aplikacionit për dhënien e lejes dhe 1.3. Shtojca 3 - Tabelat.	Article 8 Annexes 1. Integral parts of this Administrative Instruction are: 1.1. Annex 1 - Application for granting the integrated environmental permit; 1.2. Annex 2 – Method of completing the application for granting the permit; and 1.3. Annex 3 - Tables.	Član 8 Dodatak 1. Sastavni delovi ovog Administrativnog Uputstva su: 1.1. dodatak 1 - Zahtev za izdavanje integrisane ekološke dozvole; 1.2. dodatak 2 –način ispunavanja zahtev za izdavanje dozvole; I 1.3. Dodatak 3 – Tabele.

Neni 9 Shfuqizimi Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Vendimi me Nr. Prot. 3236/22, i datës 03.06.2022, për Caktimin e Formës, Përbajtjes dhe Mënyra e Plotësimit të Aplikacionit për Leje të Integruar.	Article 9 Repeal Upon entry into force of this Administrative Instruction, there shall be repealed the Decision with Prot. No. 3236/22, dated 03.06.2022, on Formatting, Content and Method of Completing the Application for Integrated Permit.	Član 9 Ukidanja Stupanjem na snagu ovog Administrativnog Uputstva, ukiada se Odluka br. Prot. 3236/22 od 03.06.2022.godine za određivanje obrasca, sadržaja i načina popunjavanja zahteva za dobijanje integrisane dozvole.
Neni 10 Hyrja në fuqi Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.  Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës Date: <u>12/12/2024</u>	Article 10 Entry into force This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.  Minister of the Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure Date: <u>12/12/2024</u>	Član 10 Stupanje u snagu Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od dana objavljivanja u Službenom glasniku Republike Kosovo.  Ministar Ministarstva za Životnu Sredinu, Prostorno Planiranje i Infrastrukturu Datum: <u>12/12/2024</u>

SHTOJCA 1**APLIKACIONI PËR DHËNIEN E LEJES MJEDISORE TË INTEGRUAR****Formulari 1.**

Emri i operatorit

Vendi

Numri

Data

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE TË INTEGRUAR		
1.TË DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për aplikacionin		
		Implant ekzistues
		Implant i ri
		Ndryshime në implant
		Rishikimi i lejes ekzistuese
		Vazhdimi i lejes
		Ndërprerja e aktivitetit
1.2. Të dhënat për Operatorin		
1.2.1.	Emri i subjektit	
	Statusi juridik	
	Vendi	
	Adresa	
	Nr. i tel./fax	
	E-mail	
	Web adresa	
1.2.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit dhe Kodet e aktiviteve për të cilat kërkohet Leja	

1.2.3.	Emri i pronarit	
1.2.4.	Emri i personit qe menaxhon me impiantin	
1.2.5.	Personi juridik	
1.2.6.	Numri i të punësuarve	
1.2.7.	Kostoja e impiantit me investimet e reja	
1.3. Të dhënat për impiantin		
1.3.1.	Emri i impiantit	
	Adresa e lokacionit të impiantit	
1.3.2.	Data e lëshimit në punë të impiantit	
1.3.3.	Personi kontaktues për mjedis	
1.3.4	Nr. i tel/fax	
	E-mail	
	Numri i orëve të punës për kryerjen e aktivitetit	
	Dite	
	Jave	
	Muaj	
	Vit	
1.3.5.	Përshkrimi i zonës dhe lokacionit të impiantit sipas hartës së bashkangjitur	
1.3.6.	Përshkrimi i lokacionit dhe i të gjitha ndërtesave, objekteve dhe aktiviteteve të tyre në kuadër të zonës sipas hartës së bashkangjitur.	
1.3.7.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	
1.4. Lloji i aktivitetit industrial		
1.4.1.	Kategoritë e aktiviteteve industriale sipas Shtojcës 1 të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes	
1.4.2.	Përshkrimi i transportit të lëndëve para dhe produktit final	
1.4.3.	Informacioni për mjedisin në të cilat mund të ndikojë kryerja e aktiviteteve apo ndonjë aksidenti	
2. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARITË DHE LEJET E LËSHUARA		
2.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja		
2.1.1.	Përshkrim i procesit teknologjik të impiantit	
2.1.2.	Skema e procesi teknologjik	

2.1.3.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar	
2.1.4.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse, energjisë dhe ujit.	
2.2. Të dhënat për dokumentacionin e impiantit (lejet, vendimet, pëlqimet, licenca, etj.)		
2.2.1.	Lista e legjislacionit në fuqi i përdorur për kompletimin e kërkesës për leje.	
2.2.2.	Organi Kompetent përgjegjës për planifikimin dhe ndërtimin në territorin në të cilin zhvillohet aktiviteti.	
2.2.3.	Dokument i planit dhe plani urbanistik për të dhënat për kushtet urbanistike (përfshirja në planin e zhvillimit hapësinor)	
2.2.4.	Numri kadastral i parcelës dhe dokumentit të lëshuar nga autoritetet kompetente	
2.2.5.	Leja e ndërtimit	
2.2.6.	Leja ujore për përdorim të ujit	
2.2.7.	Leja ujore për shkarkim të ujit	
2.2.8.	Lejet tjera që ndërlidhen me veprimtarinë	
3. MENAXHIMI I MBROJTJES SË MJEDISIT		
3.1.	Politika e mbrojtjes së mjedisit	
3.2.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	
3.3.	Raportimi	
3.2.4.	Praktika më e mirë e menaxhimit të mbrojtjes së mjedisit	
4. SHFRYTËZIMI I TEKNIKAVE MË TË MIRA NË DISPOZICION (TMD)		
4.1.	Përshkrimi i impiantit, procesin e prodhimit dhe procesin e punës	
4.2.	Të dhënat për TMD e cila është shfrytëzuar për vlerësimin e procesit	
4.3.	Zëvendësimi i materive të rrezikshme	
5. SHFRYTËZIMI I RESURSEVE		
5.1.	Lëndët e para, materialet ndihmëse dhe të tjera	
5.2.	Lista e rezervuarëve dhe objekteve të tjera për ruajtjen e substancave kimike.	

5.3.	Energjia	
5.4.	Uji	
5.5.	Të dhënat mbi shfrytëzimin e resurseve(lënda e papërpunuar, materialet ndihmëse, energjia dhe e uji)	
6. NDIKIMET NE MJEDIS DHE MASAT PER ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE		
6.1. Ajri		
6.1.1.	Pikat e burimit të emisionit të materieve ndotëse	
6.1.2.	Burimet difuzive të emisionit të materieve ndotëse	
6.1.3.	Emisionet në ajër të cilat vijnë nga materiet të cilat kanë aromë të theksuar	
6.1.4.	Ndikimi i ndotëseve në cilësinë e ajrit	
6.1.5.	Sistemi për zvogëlimin e materieve ndotëse	
6.1.6.	Kontrolli dhe matjet	
6.1.7.	Raportimet	
6.2. Uji		
6.2.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	
6.2.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujit	
6.2.3.	Lloji i materieve ndotëse	
6.2.4.	Të dhënat për trajtimin e ujërave të ndotura që dalin nga procesi i kryerjes së aktiviteteve.	
6.2.5.	Ndikimi në kualitetin e trupave ujqor	
6.2.6.	Kontrolli dhe matjet	
6.2.7.	Raportimi	
6.3. Mbrojtja e tokës dhe ujërave nëntokësore		
6.3.1.	Në rast kur ujërat e ndotura shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësorë.	
6.3.2.	Në rast kur ujërat e ndotura nuk shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësorë.	
6.3.3.	Raporti bazë	
6.4. Në rast se ujerat e ndotura i bartë në një implant tjetër për trajtim është e nevojshme të i paraqes të dhënat si në vijim		
6.4.1.	Emri i operatorit i cili pranon ujin e ndotur për trajtim	
6.4.2.	Vendi	

6.4.3.	Nr. i tel.	
6.4.4.	Email-i	
6.4.5.	Të dhënat nga leja për punën e impiantit për trajtimin e ujerave të ndotura	
6.4.6.	Të dhënat për kontratën e lidhur	
6.4.7.	Leje nga autoriteti kompetent për trajtimin e ujerave të ndotura(kopje)	
7. MENAXHIMI I MBETURINAVE		
7.1.	Plani i menaxhimit të mbeturinave	
7.2.	Prodhim i mbeturinave	
7.3.	Klasifikimi dhe pranimi i mbeturinave	
7.4.	Magazinimi i përkohshëm i mbeturinave	
7.5.	Transporti i mbeturinave	
7.6.	Përpunimi i mbeturinave: trajtimi dhe riciklimi	
7.7.	Impianti, pajisjet dhe teknologjia	
7.8.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër	
7.9.	Deponimi i mbeturinave	
7.10.	Impianti, pajisjet dhe teknologjia	
7.11.	Dërgimi për deponimin të operatori tjetër	
7.12.	Kontrolli dhe matja	
7.13.	Dokumentimi dhe raportimi	
8. ZHURMA DHE VIBRIMI		
8.1.	Burimet	
8.2.	Emisionet	
8.3.	Kontrolli dhe matje	
8.4.	Raportimet	
9. VLERËSIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSIT E THEKSUARA		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre.	
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	
9.4.	Raport mbi gjendjen e sigurisë	
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Fillimi i punës së impiantit nëse si rezultat paraqiten ndikimet negative në mjedis.	
10.2.	Problemet (teknologjike, elektrike, makinerike etj.)	
10.3.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	
10.4.	Ndalja e punës	
11. NDËRPRERJA E PJESSHME OSE E PLOTE PUNËS SË IMPIANTIT		
11.1.	Përshkrimi i masave që duhen marrë pas mbylljes së impiantit.	
11.2.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas ndërprerjes së pjesshme ose të përfundimit të aktivitetit të impiantit	

Personi përgjegjës për mjedis

Emri mbiemri

Nënshkrimi

Personi përgjegjës i kompanisë

Emri Mbiemri

Nënshkrimi

SHTOJCA 2

MËNYRA E PLOTËSIMIT TË APLIKACIONIT PËR DHËNJEN E LEJES

1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

1.1. Të dhënat për Aplikacionin

Të shënohet në rubrikën:

- Impiant ekzistues;
- Impiantit i ri;
- Ndryshime në impiant;
- Rishikimi i lejes ekzistuese;
- Vazhdimi i lejes;
- Mbyllja e impiantit.

Aplikacioni duhet të jetë i plotësuar edhe në rastin e ndryshimeve në impiant, si dhe në rastin e vazhimit të lejes.

Me aplikacion të dorëzohet deklaratë që konfirmon se informatat që gjinden në aplikacion janë të vërteta, të sakta dhe të plota.

Nëse ndonjë informate në aplikacion përmban të dhëna kofidenciale, ose të dhëna që përfaqësojnë një sekret biznesi, operatori duhet të specifikojë se për cilat informata bëhet fjalë.

1.2. Të dhënat për Operatorin

Informata për operatorin gjegjësisht parashtruesin e aplikacionit, statusin juridik të subjektit (aplikuesit), personin kontaktues, numri e regjistrimit dhe datën e regjistrimit në regjistër të biznesit.

Nëse ka një dallim mes operatorit dhe personit juridikë se kujt i takon impianti, është e nevojshme të paraqiten të gjitha informatat në lidhje me personin juridik (ose ndërmarrjen shoqërore dhe subjektet e tjera ekonomike).

1.2.1. deri në 1.2.6. Shënoni të gjitha detajet e kërkuara

1.2.7. Kostoja e impiantit me investime të reja

Specifiko të dhënat: shpenzimet e investimeve kapitale duke përfshirë edhe investimet e reja, numri i punonjësve, personat të tjerë të punësuar apo të angazhuar për kryerjen e aktiviteteve.

1.3. Të dhënat për impiantin

Shënoni të gjitha informatat e për impiantin, emri i impiantit, adresa e lokacionit të impiantit dhe të dhënat mbi personin kontaktues (emri, adresa e personit kontaktues, pronarit). gjerësia dhe largësia gjeografike), në lidhje me lokacionin dhe infrastrukturën e

zonës, informacionin rreth shfrytëzimit të lokacioneve fqinje (qëllimi dhe llojin e objekteve dhe aktiviteteve të cilat zhvillohen).

Nëse ka të bëjë me: banim, zonë industriale, zonë publike, është e nevojshme të bashkëngjitet edhe harta.

Nëse ka të bëjë me zonë e mbrojtur është e nevojshme të bashkëngjitet harta që tregon zonën e mbrojtur dhe shpjegoni aktivitetet që janë ndaluar ose janë të kufizuara në atë zonë, të cilat janë të përcaktuara me ligj.

1.3.1. deri në 1.3.3. Shënoni të gjitha detajet e kërkuara

1.3.4. Shënoni numrin e orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve dhe numrin e përgjithshëm të orëve të punës dhe ditëve në vit.

1.3.5. deri në 1.3.7. Shënoni të gjitha detajet e kërkuara

1.4. Lloji i aktivitetit industrial

1.4.1. Identifikoni llojin e aktivitetit, gjegjësisht implantit, t'i ipet emri dhe numri rendor në bazë të Ligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, Shtojca 1 për kategoritë e aktiviteteve industriale për të cilat lëshohet leja.

1.4.2. Shënoni numrin dhe llojin e mjeteve dhe frekuenca e hyrjes së tyre dhe daljes nga impianti. Transporti përfshin transportin e personelit, lendeve të para, materialeve ndihmëse, produktet dhe mbeturinat.

1.4.3. Shënoni të gjitha detajet e kërkuara

2. Përmbledhje e të dhënave mbi veprimtaritë dhe lejet e lëshuara

2.1. Përshkrimi i aktiviteteve të cilat kërkojnë Leje

2.1.1. Jepni një përshkrim të procesit teknologjik të implantit

2.1.3. Shënoni kapacitetin e projektuar i cili është prodhim maksimal i mundshëm gjatë 24 orë/ditë dhe kapaciteti i realizuar.

2.1.4. Jepni pasqyrë të përmbledhur të përdorimit të planifikuar të lëndëve të para, materiale ndihmëse, të energjisë dhe ujit.

2.2. Të dhënat e dokumentacionit për implantin (lejet, licencat, pëlqimet etj.)

2.2.1. Shënoni të gjitha Ligjet, rregulloret, udhëzimet, dokumente të cilat janë shfrytëzuar me rastin e plotësimit të aplikacionit.

2.2.2. deri në 2.2.8. Shënoni të gjitha detajet: autoritetin kompetent për planifikim dhe ndërtimin dhe menaxhimin e ujit, dokumentet e planifikimit, planet urbane me të dhëna

mbi planifikimin e kushteve për organizimin e hapësirës dhe përfshirjen e tij në planin e zhvillimit hapësinor, informatat kadastrale mbi pronësinë e tokës.

Në këtë pjesë, lista e informacionit për të gjitha lejet dhe licencat e lëshuara: leja e ndërtimit, leje për shfrytëzimin e ujit, leje për shkarkimin e ujërave të ndotura, pëlqimi mjedisor, pëlqimi nga AME, licence nga KPMM, leje nga KPMM dhe dokumente tjera.

3. Menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit

3.1. Nëse një kompani ka miratuar një politikë të mbrojtjes së mjedisit specifik informacionin në lidhje me të.

3.2. Në qoftë se kompania e zbaton sistemin e mbrojtjes së mjedisit të përfshihen të dhënat për zbatimin e këtij sistemi, duke përfshirë të dhënat mbi sistemin standard që është aplikuar dhe sistemin e certifikuar (ISO 9000, ISO 14001), data e deklarimit dhe të verifikimit.

3.3. Në qoftë se kompania e zbaton sistemin e mbrojtjes së mjedisit kompania duhet të paraqet autoritetit kompetent një kopje të raportit vjetor të menaxhimit të mjedisit.

3.4. Shënoni informacion te detajuar për:

- Strukturën menaxhuese, duke përfshirë organizimin dhe përgjegjësitë në mbrojtjen e mjedisit;
- Vlerësimin në përmbushjen e kërkesave të mbrojtjes së mjedisit;
- Menaxhimin e mbeturinave;
- Trajtimin dhe ruajtjen e kemikateve;
- Uljen e përdorimit të lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse;
- Parandalimi i aksidenteve, rrjedhjet e substancave të rrezikshme, masa emergjente, plane;
- Mirëmbajtja e pajisjeve, duke përfshirë rezervuarët për deponim (magazinim), sistemin e kanalizimit, plane për largimin e pajisjeve pas ndërprerjes së përdorimit.

Elementet kryesore të sistemit të mbrojtjes së mjedisit janë:

- Politika e mjedisit;
- Programi i menaxhimit të mjedisit;
- Një përshkrim i strukturës së menaxhimit që është i lidhur me subjektin e aktiviteteve: personave përgjegjës; ndarjen e përgjegjësisë për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe komunikim të rregullt në mes strukturave menaxhuese dhe të punësuarve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.

Operatorëve ju rekomandohet të punojnë në zbatimin e sistemit ISO 14001 dhe zhvillimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollin e mbrojtjes së mjedisit.

4. Shfrytëzimi i teknikave më të mira në dispozicion (TMD)

4.1. Shënoni të gjitha informatat për impiantin, procesin e prodhimit dhe procesin e punës që ndërlidhen me TMD-n.

4.2. Shënoni referencën e TMD-s që është përdorur për procesin e prodhimit (Emrin e organizatës, datën e dhënies, arsyen e shfrytëzimit të dokumentit të TMD-s).

4.3. Përshkruani materiet e rrezikshme të përdorura në procesin e prodhimit dhe mënyrën se a është e mundur për të bërë zëvendësimin e tyre për të arritur TMD.

Për çdo proces të punës të përshkruhet deri në çfarë niveli është teknologjia në përputhje me TMD. Të dhënat mbi metodat, teknologjitë dhe teknikave të tjera për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ të impiantit në mjedis dhe krahasimi i tyre me kërkesat e TMD, mund të paraqiten në mënyrë të shkruar apo tabelare, si vijon:

Kërkesat e TMD-ë të vendosura në dokumentet referente	Dokumentet (emri)	Pëlqimi me kërkesat e TMD (po/jo)	Plani i veprimit (data e miratimit dhe emri)
Shfrytëzimi i resurseve			
Lëndët e para dhe materialet ndihmëse			
Energjia			
Emisionet në ajër			
Emisionet në ujë			
Toka dhe ujërat nëntokësore			
Menaxhimi me mbeturina			
Zhurma dhe vibrimet			
Vlerësimi i rrezikut nga aksidentet			

Për impiantet ekzistuese operatori duhet të përshkruaj një plan të përmisimit të veprimit me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

Në rast se operatorit të ndonjë impiantit ekzistues, i kërkohet që t'i ofrojë Ministrisë një Plan të Përmirësimit, një plan i tillë duhet të përmbaj informatat si në tabelën në vijim.

Nr.	Aktiviteti	Investimet për këtë aktivitet (EUR)	Data e planifikuar e fillimit të aktivitetit	Data e planifikuar e përfundimit të aktivitetit	Rezultatet e aktivitetit
1.					
2.					

Aktiviteti: Përshkrimi i aktivitetit/aktiviteteve të cilat do të kryhen për të arritur nivelin me legjislacionin mjedisor.

Rezultatet e aktivitetit: të përshkruhet rezultati (shembull: zvogëlimi i shkarkimeve);

5. SHFRYTËZIMI I RESURSEVE

Përshkruani shfrytëzimin e resurseve, si është siguruar zvogëlimi i shfrytëzimit të lëndëve të para, materialeve ndihmëse, energjisë dhe të ujit përmes ripërdorimit, teknologjinë e veçantë etj.

5.1. Të ipet lista e lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse, substancat dhe produktet që janë të prodhuara (si produkt) ose të përdorura në prodhim. Lista duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të përfshijë të gjitha materialet të përdorura. Të dhënat mbi sigurinë, toksicitetin, aromën dhe të dhëna të tjera duhet të jenë e bashkangjitura. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet materialeve dhe produkteve që përmbajnë substanca të rrezikshme dhe duhet përcaktuar sipas rrezikut (etiketë R- shenja) për çdo substancë.

5.2. Të ipet lista e rezervuarëve për magazinim: viti i prodhimit, numrin e impiantit, emrin e prodhuesit, përmbajtjes, llojit dhe madhësisë (dimensione, vëllimi, shtypja, qëllimin), datën dhe rezultatet e shqyrtimit (vërtetimit) të fundit (emri i personit që ka kryer verifikimin) lokacionin e vendndodhjes dhe distancën nga kolektori i kanalizimit, mënyra se si është siguruar mbrojtja e tokës.

5.3. Shëno informacion në lidhje me shfrytëzimin e energjisë totale për kryerjen e aktiviteteve, sidomos:

- Shfrytëzimin e energjisë dhe karburanteve sipas kategorive të caktuara;
- Ndaras trego nëse është e mundur, shfrytëzimi i energjisë në kuadër të pjesëve të veprimtarive të ndryshme;
- Përshkruaj masa për të reduktuar shfrytëzimin e energjisë;
- Përshkruaj masat për të reduktuar emisionet gjatë shfrytëzimit të energjisë;
- Jepni një përshkrim të pajisjeve për trajtim, duke përfshirë një skemë të trajtimit;
- Përshkruani procesin e prodhimit të energjisë;
- Ndaras përshkruaj prodhimin e energjisë sipas kategorive të veçanta;
- Përshkruani efikasitetin e prodhimit të energjisë.

5.4. Përshkruaj të dhënat për përdorim të përgjithshëm gjegjësisht konsumi i ujit, sidomos:

- Ndaras përshkruaj përdorimin e ujit për pjesë të ndryshme të veprimtarisë;
- Ndaras përshkruaj konsumin e ujit sipas kategorive të caktuara: ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, ujërat e ricikluara;
- Përshkruaj masa për të reduktuar konsumin e ujit.

5.5. Të përshkruhen qarte përdorimi i resurseve (lëndë e papërpunuar, materialet ndihmëse, energji dhe uji).

6. NDIKIMET NE MJEDIS DHE MASAT PER ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE

6.1. Ajri

6.1.1. -6.1.5. Shëno cilësinë e ajrit gjatë plotësimit të aplikacionit, duke përfshirë kushtet meteorologjike. Jepni pasqyrën krahasuese të vlerave të përqendrimeve të lejuara të disa materieve ndotëse në ajër. Ndikimi në cilësinë e ajrit: efektet e emisioneve në mjedis si dhe efektet e lëvizjes ndërkufitare të ndotësve në ajër.

Përshkruani në vijim: sistemin ekzistues për trajtimin e materieve të ndotura, burimet e ndotjes, aromën, përqendrimin e materieve të ndotura, ndikimi në mjedis përreth implantit si dhe sistemin e monitorimit dhe kontrollit.

Vlerësimin e plotë të sistemit ekzistues për trajtimin e materieve ndotëse si dhe sistemi i planifikuar i avancimit për të arritur standardet e TMD-s.

Paraqit të gjitha informatat për pikat e emisioneve në ajër, së bashku me tabelat, harta, vizatime dhe dokumentacionin shoqërues.

Shënoni të dhënat për burimet e ndotjes, masat e kontrollit dhe informacionit mbi ndikimin e tyre në mjedis. Bashkëngjit detajet e plota dhe mbështetjen e informacionit dhe skemat e duhura.

Shënoni të dhëna për kundërmimet (ere e rëndë) dhe materiet prej nga e kanë origjinën, karakteristikat dhe masat për zvogëlimin e tyre.

Shënoni të dhëna përmblledhëse për vlerësimin e ndikimit në mjedis të emisioneve ekzistuese ose emisionet e propozuara në mjedis, duke përfshirë edhe mediumet tjera.

Jepni një rishikim dhe përshkruajë monitorimin e emisioneve, kontrollin, masat që janë planifikuar në pajisje.

6.2. Uji

6.2.1. - 6.2.5. Shëno gjendjen e cilësisë së ujërave sipërfaqësore, përfshirë kushtet hidrologjike në zonën ku planifikohet shkarkimi i ujit të ndotur. Shëno gjendjen e cilësisë së niveleve të ndryshme të ujërave nëntokësore, duke përfshirë përshkrimin e kushteve hidrogeologjike.

Ndikimi në cilësinë e ujit:

- Ndikimi në ujërat sipërfaqësor;
- Ndikimet e drejtpërdrejtë;
- Përdorimin e ujit;
- Shkarkimin e ujërave të ndotura;
- Ndikimin e sistemeve të jashtëm për trajtimin e ujërave të zeza;
- Efektet e lëvizjes ndërkufitare të ndotësve në ujë;
- Ndikim të ujërave nëntokësore;

Përshkruani në vijim: sistemin ekzistues për trajtim, impiantin për trajtim, sasia e ujërave të ndotura, shkarkimet e ujit nga procesi në mjedis, ndikimi në cilësinë e trupit ujor, si dhe programet e monitorimit dhe kontrollit të shkarkimeve.

Sistemet për trajtimin e ujërave të zeza dhe shkarkimin e ujërave sipërfaqësore. Kërkohet program për arritjen e përmirësimeve të standardeve për sjelljen e emisioneve nën vlerat kufitare.

Shëno të gjitha informatat në lidhje me sistemin e ujërave të zeza sistemin për mbledhjen, duke përfshirë ndonjë sistem të trajtimit, me skemat të bashkangjitura.

Nëse ujërat e zeza shkarkohen në sistemin ekzistues të kanalizimit, specifikojë për llojet dhe sasi të (koncentrimin) e lejuar të substancave të dëmshme që mund të lëshohen në sistemin e kanalizimit, përputhja me vlera të përcaktuara, shpeshtësinë e matjes, kontrollit, raportimin dhe të dhënat tjera relevante.

Lista e pikave të shkarkimeve, së bashku me harta, vizatime edhe dokumentacionit shoqërues, të dhënat mbi rrjedhën është gjithashtu pjesë e bashkangjitur.

Përshkruani shkarkimin e ujërave nga procesi, specifikojë sasinë dhe masat për zvogëlimin e temperaturës.

Jepni të dhëna përmbledhëse për vlerësimin e ndikimit për emisionet ekzistuese përfshirë edhe mediumet tjera.

6.2.6-6.2.7. Përshkruani monitorimin, masat e kontrollit dhe të raportimit.

6.3. Mbrojtja e tokës dhe të ujërave nëntokësore

Shëno informacion në lidhje me praninë e substancave të rrezikshme dhe të dëmshme në tokë, si dhe karakteristikat morfologjike të shtresës sipërfaqësore të tokës. Jepni pasqyrën krahasuese të vlerave të përqendrimeve të lejuara të disa materieve ndotëse në tokë.

6.3.1.-6.3.2. Përmbledhje e të dhënave mbi ndotjen sipërfaqësorë dhe ndotjen nëntokësore dhe / ose ndotjen e ujërave nëntokësore.

Bashkëngjitni informacion të plotë, duke përfshirë studime hulumtuese, vlerësimet apo raport, rezultatet e monitorimit, vendndodhja dhe metodat e matjes, planet dhe dokumentet tjera përcjellëse.

Në raste të rralla dhe vetëm në rastin e shkarkimeve të substancave të rrezikshme në tokë dhe të ujërave nëntokësore, të dhënat e domosdoshme për pasojat dhe ndikimin e tyre duhet të përfshijnë:

- Përmbledhje e informacionit për të gjitha emisionet e drejtpërdrejta në tokë apo në ujërat nëntokësore;

- Informata të plotë në lidhje me vendin e lëshimit(shkarkimin) ose fushave (në rast të zgjerimit të hapësirës), së bashku me harta, vizatime dhe dokumentacionin shoqërues;
- Informacion për substanca të rrezikshme;
- Informacion për trajtim, duke përfshirë edhe paraqitje me vizatimin e duhur.

6.3.3. Raporti bazë

Kur aktiviteti përfshin përdorimin, prodhimin ose lirim të substancave të rrezikshme duke pasur parasysh mundësinë e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore, operatori duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë Ministrisë raportin bazë para fillimit të funksionimit impiantit.

Raporti bazë duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për të përcaktuar gjendjen e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore në mënyrë që të bëhet një krahasim sasior me gjendjen pas ndërprerjes përfundimtare të aktiviteteve.

7. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Shëno llojet dhe sasi të mbeturinave që prodhohen, si dhe mënyra e planifikimit (parandalimin e shfaqjes, reduktimi i sasisë së përbërësve të dëmshëm, ripërdorimin dhe riciklimin, trajtimin, deponimin).

Një përshkrim i detajuar i grumbullimit të mbeturinave dhe deponimit përfundimtar.

7.1. Bashkëngjitni një plan për administrimin e mbeturinave.

7.2. gjerë në 7.13. Shëno të gjitha informatat në lidhje me llojet e mbledhjes së mbeturinave, transportit të mbeturinave dhe marrësit të mbeturinave(emrin, klasa, sasia totale, burimi).

Shëno llojin e përpunimit dhe largimit të mbeturinave (metodën, vendndodhjen, sasinë, etj).

Mbeturinat e eksportuara jashtë vendit, paraqitni detajet e transportit të mbeturinave, emrin e personit i cili merret me trajtim të mbeturinave dhe deponimin përfundimtar në vend, si dhe licencën dhe kontratën.

Jepni informacion të plotë në lidhje me trajtimin e mbeturinave të rrezikshme. Specifikoni të dhënat mbi kontrollin dhe matjen, analizën e mbeturinave (marrjen e mostrave, karakteristikat, klasifikimi dhe kategorizimi).

Bashkëngjitni një raport të përfunduar për ekzaminimin e mbeturinave, klasën dhe kategorinë.

8. ZHURMA DHE VIBRIMI

Shëno gjendjen e zhurmës përreth fabrikës në lidhje me nivelet e lejuara të zhurmës. Nëse punojnë në zonat e mbrojtura siguro një hartë (drejtimet) të efekteve të zhurmës.

Jepni një përshkrim të sistemit ekzistues, mënyrën për zvogëlimin e zhurmës, burimet e zhurmës, një përshkrim të programit për monitorimit dhe kontrollit.

8.1. gjer në 8.2. Specifiko nivelin e zhurmës në distancë të caktuar, niveli i zhurmës në vende të ndjeshme, afër objekteve fqinje. Bashkëngjitni një hartë, diagramet, dokumentet mbështetëse, duke përfshirë informacione mbi reduktimin e nivelit të zhurmës dhe masat e propozuara. Nëse është e nevojshme, edhe vibrimet në tabelë të veçantë.

9. VLERËSIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSIT E THEKSUARA

9.1. gjerë në 9.5. Shëno gjendjen e sigurisë , rreziqet e aksidenteve të mundshme dhe planin e reagimit.

Përshkruaj masat për të parandaluar aksidentet. Vendosë në vlerësimin e rrezikut, planin e mbrojtjes kundër aksidenteve apo një plan masash urgjente.

Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm;

Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre;

Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave;

Raport mbi gjendjen e sigurisë;

Plani për mbrojtjen nga zjarri.

10. MASAT NË RASTET E PUNËS JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1. gjerë në 10.4. Përshkruani masat për mënyrën jo stabile të punës së impiantit në qoftë se: Aktiviteti i takon kategorisë së aktiviteteve me rrezik të theksuar për fillimin e punës së pajisjes.

- Problemet e rrjedhjes (masat e planifikuara për të ndaluar punën apo për vazhdimin e punës);
- Ndalja momentale (mos planifikimi i ndaljes së punëve të paplanifikuara në raste emergjente dhe në raste të tjera);
- Pezullimi (ndërprerje e planifikuar për shkak të nevojave të mirëmbajtjes dhe për raste të tjera).

11. NDËRPRERJA E PJESSHME OSE E PLOTE E PUNËS SË IMPIANTIT

11.1. Përshkrimi i masave që duhen marrë pas mbylljes së impiantit.

11.2. Përshkrimi i rehabilitimit të zonës dhe ri kultivimin e lokacionit të impiantit pas ndërprerjes së pjesshme ose të përfundimit të aktivitetit të impiantit.

mi (1)	i (2)						mit (5)	(t)		(6)	

Shënim:

- (1) Lloji i lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse të përdorura në prodhim.
- (2) Llojet e materialeve: metal, dru, plastikë, minerale, produktet e naftës, organike, materie inorganike, bimore, shtazore, ngjyra, me më pak se 5% VOC, ose më shumë se 5% VOC dhe të tjerët;
- (3) CAS: Index shënon një substancë të rrezikshme;
- (4) Klasifikimi;
- (5) Magazini: në fuçi, tanket, nëntokësore, jashtë ose në ambiente të mbyllura dhe të tjera.
- (6) Shuma e substancave kimike në produktin përfundimtar dhe mjedis më të saktë e shprehur në%.

Tabela 3

Substanca të rrezikshme të krijuar gjatë procesit të prodhimit
Procesi jonë i prodhimit nuk gjeneron ndonjë produkt të rrezikshëm, por vetëm...

Nu mri ose she nja	Substancat ose prodhimi (1)	Lloji i substancave kimike ose prodhimi (2)	Shfrytëzimi	CAS numë r (3)	Kategoria (4)	Rrezik (R) (4)	Siguria (S) (4)	Magazini dhe sasia (t)dhe mënyr a e magazini nimit (5)	Sasia e shfrytë zimit në vit (t)	% në prodhim (6)	% në mbeturina (6)	% në ujërat ndotura (6)	% e emisionit në ajër (6)

(1) Lloji i lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse të përdorura në prodhim.

- (2) Llojet e materialeve: metal, dru, plastikë, minerale, produktet e naftës, organike, materie inorganike, bimore, shtazore, ngjyra, me më pak se 5% VOC, ose më shumë se 5% VOC dhe të tjerët.
- (3) CAS: Index shënon një substancë të rrezikshme.
- (4) Klasifikimi.
- (5) Magazinimi: në fuçi, tanket, nëntokësore, jashtë ose në ambiente të mbyllura dhe të tjera. Shuma maksimale e magazinimit.
- (6) Shuma e substancave kimike në produktin përfundimtar dhe mjedis më të saktë e shprehura në%.

Tabela 4
Substanca të rrezikshme kimike ose materialet në produktin final

Numri ose shenja	Substancat kimike ose prodhimi (1)	Lloji i materialit (2)	CAS numri (3)	Kategoria (4)	Rrezik (R) (4)	Siguria (S)	% në prodhim

Shënim:

- (1) Lloji i materialit që është krijuar ose izoluar në prodhim.
- (2) Materiali: metal, dru, plastikë, minerale, produktet e naftës, organike, materie inorganike, bimore, shtazore, ngjyra, me më pak se 5% VOC, ose më shumë se 5% VOC dhe të tjerët.
- (3) CAS: Index shënon një substancë e rrezikshme.
- (4) Klasifikimi

Tabela 5.
Shfrytëzimi i burimeve të energjisë në impiantet industriale
Shfrytëzimi i lëndëve djegëse për prodhimin e nxehtësisë dhe energjisë elektrike

Lloji i lëndës djegëse	Emri (prejardhja)	Sasia e shfrytëzimit në vit	Përmbajtja e sulfurit (%)	Përmbajtja e hirit (%)	Fuqia e poshtme termike (KJ/kg) apo (KJ/m³)	Përdorur të		
						Procesi i prodhimit	Ngrohja (1)	Transporti
								Prodhimi i energjisë elektrike

Gazi natyral (m ³)																				
Thëngjilli (t)																				
Disell (t)																				
Petroleji (t)																				
Benzina(t)																				
Karburantët për furra të larta (t)																				
Karburantët nga rreshpet bituminoze (t)																				
Dru (t)																				
Torfa (t)																				
Të tjera (t)																				

(1) Shënim:

Për qëllime të ngrohjes dhe të ngrohjes së ujit dhe për qëllime jo prodhimi (jo për procesin e prodhimit).

Tabela 9

Karakteristikat e pajisjes për matjen e hargjimit të nxehtësisë së energjisë elektrike

Numri i vendeve matëse (1)	Parametrat të cilët matën	Pajisjet matëse		Lloji i kontrollit (kontinuale/periodike	Frekuenca e matjeve	Dokumentet (librat)
		Emri	Lloji			

Tabela 10.
Shfrytëzimi i ujit

Burimet e ujit dhe llojet e shfrytëzimit	Konsumimi i ujit në m ³ /vit	Për ftohje m ³ /vit	Për proces të prodhimit m ³ /vit	Për pastrimin e hapësirave m ³ /vit	Për nevoja jo prodhuese (kuzhinë e të ngjashme) m ³ /vit	Për qëllime tjera m ³ /vit
Furnizuesit e jashtëm						
burimet vetanake (private)						
Burimet liqet ose lumejt						
Tjera						
Gjithsejtë						

Tabela 11
Emissionet në ajër dhe kontrolli i tyre

Pajisja, procesi, njësia e cila e shkarkon ndotjen			Materia e ndotur		Karakteristikat e emissionit para trajtimit			Pajisja për trajtimin e gazrave			Karakteristikat e emissionit pas trajtimit		
Lloji	Numri i burimit të ndotjeve	Afati (zgjatja) e operacionit (h)		Shenja	Emri	mg/m ³	g/s	t/vit	Emri dhe lloji	Efikasiteti	mg/m ³	g/s	t/vit
		ditore	vjetore										

Shënim:

Përbajtja (koncentrimi dhe sasia materiet e ndotura e shprehur në 0° C, 101.3 KPa dhe pjesën referente tëO₂ në gazin e thatë.

Tabela 12
Karakteristikat teknike të kaldajës

Karakteristikat e pajisjes				
Numri i pajisjes	Emri	Lloji	Kapaciteti (MW)	Koha e punës (h/vit)
				Shkalla e shfrytëzimit (%)

Tabela 13
Karburantet për kaldajë/pajisjet për ngrohje

Numri i pajisjes	Lënda djegëse			
	Emri	Hargjimi maksimal		Përbajtja e
		t/h apo m³/s (për karburant të gazet)	t/vit (për karburant të gazet m³/vit)	sulfurit %
